



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranverorë

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 10
Prishtinë, më 16 Maj 2012, në orën 10:00 salla N-225
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCEVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Ramiz Lladrovci, Mursel Haljilji, Valbona Dibra, Armend Zemaj, Adem Grabovci, Bali Muharremaj, Afrim Hoti, dhe Albert Kinolli.

Të ftuar: z.Lars Lage OLOFSSON, auditor i përgjithshëm, Besim Beqaj –MZHE, Ramadan Sejdiu-NJMNP/MZHE, Raif Preteni-ZRRUM.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Fatime Qorri - koordinatorë, Mehmet Simnica-zyrtar i fushës për ekonomi, Artan Venhari dhe Albert Krasniqi- KIPRED, Butrint Ymeri - praktikant.

Mbledhjen e kryesoi: Ali Sadriu - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 08.05.2012,
3. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për efikasitetin në menaxhimin dhe monitorimin e Kompanive të Ujërave.
4. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të Pasqyrave financiare të Zyrës Rregullative të Ujërave dhe Mbeturinave,
5. Të Ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri miratoi rendin e ditës pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 08.05.2012

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri miratoi Procesverbalin e mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 08.05.2012, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për efikasitetin në menaxhimin dhe monitorimin e Kompanive të Ujërave

Kryetari – Propozoi që shqyrtimi i kësaj pike të rendit të ditës të bëhet në një mbledhje tjetër të Komisionit, meqenëse prania e ministrit është e domosdoshme. Ishte i mendimit që Komisioni të harmonizoj agjendën me ministrin.

Ramiz Lladrovci- Ishte i mendimit që meqenëse përfaqësuesi i NJMNP është i pranishëm dhe mund të jap informacionet e duhura, Komisioni të vazhdoj me shqyrtimin e këtij raporti.

Ramadan Sejdiu, NJMNP/MZHE- Njoftoi anëtarët e Komisionit se për shkak të udhëtimit zyrtar ministri e ka pasur të pamundur pjesëmarrjen në këtë takim. Po ashtu njoftoj anëtarët e Komisionit se NJMNDP deri më datën 17 Maj 2012, ka kërkuar nga Kompanitë e Ujit që të bëjnë raport lidhur me veprimet e marra për të gjeturat e ZAP-it dhe rekomandimet e tyre. Ndërsa, deri më 25 Maj NJMNP do ta bëjë përmbledhës këtë raport për ZAP-in.

Armend Zemaj – Kërkoj që Komisioni të mos lëshohet në shqyrtim të këtij raporti. Prezenca e ministrit është e domosdoshme, pavarësisht që informatat mund ti jap përfaqësuesi i NJMNP. Kjo sepse edhe rekomandimet që do të dalin nga Komisioni do të ishin të pa ballafaqeshme me Ministrin. Ministri është i obliguar t'i raportoj Kuvendit. Dhe Komisioni nuk duhet t'ja përshtat agjendën punës së tij. Kjo do ta pengonte Komisionin në punën e tij dhe realizimin e detyrave. Nëse ministri nuk i përgjigjet ftesës së Komisionit, atëherë Komisioni shqyrton raportin pa prezencën e tij dhe çështja pastaj procedohet për shqyrtim në mbledhje plenare.

Bali Muharremaj – Ishte i mendimit që Komisioni duhet të veproj njëjtë me të gjitha OB-të. Nëse deri më tani Komisioni ka insistuar për praninë e përfaqësuesve më të lartë të OB-ve, apo nëse tani pranon që në mungesë të ministrit të merret me çështjen, atëherë duhet të veproj njëjtë.

Afrim Hoti- Ndau mendimin me deputetet Zemaj dhe Muharremaj. Prezenca e ministrit është e domosdoshme sidomos për shkak të përzgjedhjes së Bordeve dhe profesionalizmin e tyre.

Albert Kinolli –Pas sqarimeve që dhanë përfaqësuesit e NJMNP ja vlen që t'i pritët edhe disa ditë në mënyrë që edhe materiali të jetë i kompletuar për këtë Komision.

Ramiz Lladrovci – Komisioni nuk ka nevojë të pres për materiale shtesë, sepse Komisioni ka për bazë Raportin e ZAP-it. Ajo do të lehtësonte punën për vitin 2012, por jo për vitin 2011.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri nxori këtë

Konkluzion

Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për efikasitetin në menaxhimin dhe monitorimin e Kompanive të Ujërave, shtyhet për datën 30 Maj 2012, ora 10:00.

4. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të Pasqyrave financiare të Zyrës Rregullative të

Ujërave dhe Mbeturinave

Kryetari - Vërehet se krahasuar me vitet e kaluar, përsëri kemi pasur një avancim në menaxhim nga ZRRUM. Nga 10 rekomandime 7 janë adresuar. Realizimi është vetëm 11% dhe në anën tjetër ZRRUM ka kërkuar mjete shtesë nga buxheti. Një element tjetër është te shpenzimet e paspecifikuara, nuk është sqaruar për çka janë këto shpenzime, dhe pse janë jashtë listës së paraparë? Po ashtu, pse ZRRUM nuk ka njësi të auditimit të brendshëm? A i siguron ZRRUM-it qëndrueshmëri fiskale faturimi vjetor, në mënyrë që të bëjë një plan veprimi për borxhet e vjetra? ZRRUM duhet të ketë një takim me njësinë monitoruese dhe kompanitë e mbeturinave që të hartohet një plan veprimi, pasi që ky problem me inkasimin nuk duhet të përsëritet vazhdimisht. Po ashtu duhet të shikohen mundësitë që ZRRUM të ketë sigurim të qëndrueshmërisë fiskal. Duhet të sigurohen mekanizma që të hyrat që planifikohen të realizohen.

Ibrahim Gjylderen, ZAP - Për ZRRUM Opinioni i ZAP-it është i pakualifikuar. Kjo nënkupton se këto pasqyra financiare prezantojnë një gjendje të drejtë të aktiviteve financiare të kësaj zyre për vitin 2011. Të gjitha transaksionet që kanë ndodhur, dhe gjithçka tjetër është prezantuar në pasqyrat financiare, dhe gjithçka ka qenë korrekte dhe në përputhje me kornizën rregullative. Disa mangësi të vogla, që janë jo materiale janë vërejtur, dhe për këtë ne kemi dhënë disa rekomandime. Këshillat më të mëdha kanë të bëjnë më mbledhjen e të hyrave të faturuara, aty ku ka ngecur kompania. Një nga rekomandimet është edhe bashkëpunimi me Njësinë Monitoruese në këtë proces. Po ashtu ka pasur edhe disa sfida rreth udhëtimeve zyrtare.

Mursel Hajlilji – Rreth të ardhurave që, shumica që është inkasuar është 11% e asaj çka është faturuar, ndërsa shpjegimi është se këto kompani nuk janë në gjendje të mirë financiare. Si mund të ndikoj gjendja e vështirë financiare pengesa faturimit? Po ashtu, në pasuesin e fundit thuhet të ardhurat e kompanive kanë qenë 7,000 euro, ndërsa nga të licencuarat rreth 1,000. Sa është planifikuar dhe sa është realizuar kjo?

Ramiz Lladrovci – Shprehu kënaqësinë për punën që e ka bërë ZRRUM-i, i cili ky do të ishte shembull shumë i mirë për OB-të e tjera. Në raport ZAP ka bërë disa të gjetura të vogla, por shihet një gatishmëri e madhe nga ana ZRRUM-it për t'i përmirësuar ato. Kërkojë nga ZRRUM që me NjQHAB të bëjë marrëveshje në mënyrë që çështja e auditimit të brendshëm të zgjidhet.

Armend Zemaj – Përcjellja e rekomandimeve nga viti në vit ka qenë dobësi e shumë OB-ve, dhe ZRRUM në këtë fushë ka bërë një hap shumë të mirë. Edhe pse janë të kuptueshme vështirësitë dhe rrethanat në të cilat zhvillohet inkasimi në Kosovë, por a ka provuar ZRRUM-i që përmes gjykatave të shtrijë këtë aktivitet? Në mënyrë që t'i inkasojë këto të hyra apo borxhe që janë trashëguar.

Raif Preteni, ZRRUM – ZRRUM përgjithësi është pajtuar me raportin e ZAP-it dhe lidhur me të gjeturat në këtë raport. Sa i përket rekomandimit lidhur me servisimin e veturave, bëhet fjalë për vetëm një veturë, pasi ajo është blerë në atë servis. ZRRUM ka pasur kontratë me operatorin ekonomik për vetëm një veturë, dhe në këtë rast është e vërtetë se për një veturë tjetër, janë ndërruar disa pjesë të saj, të cilat nuk ka qenë pjesë e kontratës, dhe vlera e tyre ka qenë rreth 300 euro. Kjo ka ndodhur për arsye se zyrtarja e prokurimit ka qenë në pushim të lehonisë, dhe nuk ka pasur mundësi të bëhet specifikacioni. Pasi zyrtarja është kthyer nga pushimi, është bërë kontratë të re dhe ky problem është rregulluar. Sa i përket mëditjeve-ZRRUM ka një marrëveshje bashkëpunimi me Entin Rregullativ të Shqipërisë me të cilët ka pasur takim, ku janë diskutuar përvojat rajonale. ZRRUM ka mbuluar të gjitha shpenzimet për pjesëmarrësit e vet. Për të hyrat, është kalkuluar taksa e licencimit për kompanitë e licencuara në sektorin e ujësjellësit dhe mbeturinave. Në sektorin e ujësjellësit ka pasur 100% efikasitet në

inkasim, ndërsa ka disa probleme tek kompanitë e mbeturinave për shkak të gjendjes së tyre momentale, si dhe ka ndikuar edhe ligji për mbeturinat, që akoma është vetëm në formë drafti në Kuvendin e Kosovës, dhe i cili nuk i sqaron kompetencat e sakta për kompanitë e mbeturinave. ZRRUM ka bërë përpjekje të vazhdueshme dhe e vetmja gjë që mund të bëjë tani është që këtyre kompanive t'u marr licencën. Raporti i auditorit tregon për borxhet e akumuluar. Janë zhvilluar takime me këto kompani, dhe ZRRUM është afër të bëjë disa marrëveshje që ato t'i paguajnë borxhet, pasi që sipas ligjit ZRRUM nuk ka të drejtë t'i fal. Përndryshe, për këtë çështje do të iniciohet padi penale ndaj këtyre kompanive. Buxheti i ZRRUM-it përcaktohet në bazë të Udhëzimit Administrativ në konsultim me Ministrinë e Financave. Kompanitë e ujit e paguajnë taksën e licencimit, por jo edhe ato të mbeturinave. Pastaj buxheti i Kosovës e mbulon shumën e mbetur përmes thesarit.

4. Të ndryshme

a). Shqyrtimi i Draftreportit të Komisionit për Komisionin për Integritet Evropian lidhur me Pikën P21 të Planit të Veprimit të Kuvendit për Integritet Evropian

Kryetari – Raporti është si rezultat i shqyrtimit që i është bërë Planit të Veprimit në mbledhjen e kaluar dhe është qëndrim i Komisionit. ndërsa lidhur me pikën P35, si Komision i parë është KBF dhe propozoi që me këtë çështje të merren një grup i anëtarëve të Komisionit.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri nxori këtë

Përfundim

- 1. Miratohet Raporti i Komisionit për Komisionin për Integritet Evropian lidhur me Pikën P21 të Planit të Veprimit të Kuvendit për Integritet Evropian.*
- 2. Lidhur me Pikën P35, të Planit të Veprimit të Kuvendit për Integritet Evropian, formohet Grupi Punues i cili do të angazhohet në aktivitetet e Komisionit për Buxhet dhe Financa. Grupi punues përbëhet nga: Armend Zemaj-kryesues, Valbona Dibra dhe Afrim Hoti.*
- 3. Për të gjitha aktivitetet, Grupi Punues njofton Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike.*

b). Mbledhja e radhës e Komisionit

Kryetari njoftoi anëtarët e Komisionit se mbledhja e radhës e Komisionit është planifikuar me datë 23 Maj 2012. Në këtë mbledhje përpos pikave të rregullta për shqyrtim do të propozohet edhe Raporti Vjetor për Funkcionimin e Sistemit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, për vitin 2011. Të ftuar: z.Bedri Hamza - ministër- MF, z.Kosum Aliu-MF, si dhe Raporti i auditimit të Pasqyrave Financiare të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, për vitin 2011, i ftuar Enver Peci-KGJK, z.Lars Lage OLOFSSON, auditor i përgjithshëm.

Mbledhja përfundoi në orën 11:40

E Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Ali Sadriu